




REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Punë/Prodato Received/Delivered	03 - 11 2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHICE	6690/2022		119



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.636/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti -kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi anëtarë si dhe Sabile Avdyli -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, duke vepruar sipas Aktgjykimit me numër A.nr.2195/2021, të datës 22.09.2022, të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.636/2021 të datës 12.07.2021 të parashtruar nga ankuesi

të cilin me autorizim e përfaqëson shoqëria e avokatëve

kundër Vendimit të datës 18.06.2021 me numër:0366 të

Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në çështjen juridike "Ndërprerje marrëdhënies së punës", duke vepruar në pajtim me nenin me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.9 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 03.11.2022, mori këtë:

V E N D I M

Pezullohet procedura administrative e nisur sipas ankesës A.nr.636/2021 të datës 12.07.2021 të ankuesit

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës në pozitën "Drejtor i Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës" sipas Vendimit me numër 04/44 të datës 27.04.2018, më datë 08.07.2021 përmes përfaqësuesit me autorizim ka parashtruar ankesë me numër protokollit 3639/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vendimit të Kryesuesit të Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë me numër 0366-2021 të datës 18.06.2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 15.07.2021, me numër protokollit 3733/2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Sekretariati i Këshillit

Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë-Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa me datë 22.07.2021 me numër protokoll 3834/2021, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Sekretariati i Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë-Ministria e Punëve të Brendshme, me shkresat e bashkangjitura.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në mungesë të kuorumit për vendosje, me shkresën me numër protokoll 4384/2021 të datës 25.08.2021 ka udhëzuar ankuesin për ushtrimin e mjeteve juridike në gjykatë sipas dispozitave të Ligjit për Konfliktin Administrativ.

Ankuesi ka ndjekur procedurat e tjera, duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative me datë 22.09.2022 ka nxjerr Aktgjykim me numër A.nr.2195/2021, i njëjti në Këshill është pranuar me datë 10.10.2022 sipas të cilit ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ka anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 25.08.2021, duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 12.07.2021.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vendosjes në lidhje me rastin ka administruar këto prova:** Ankesën e ankuesit me nr. protokoll 3639/2021 të datës 12.07.2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykim A.nr.2195/2021 i datës 22.09.2022 i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative i njëjti në Këshill është pranuar me datë 10.10.2022 me numër protokoll 6033/2022; Njoftim me numër protokoll 4384/2021 i datës 25.08.2021; Autorizim nga N.TH. për shoqëria e avokatëve Vokshi dhe Lata i datës 20.05.2021; Fletë kthesë e N.TH, datë 25/08/2021; Pliko me numër R1553333 e datës 08.07.2021; fletë kthesë e datës 15.07.2021; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 15.07.2021; Përgjigje në ankesë me numër protokoll 3834/2021 e datës 22.07.2021; Përgjigje në ankesë me nr.0455/2021 e datës 21.07.2021; Vendim me Nr.04/44 i datës 27.04.2018; Vendim i Këshillit Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë me Nr.0366-2021 i datës 18.06.2021; Vendim për pezullim nga detyra të N.TH. Drejtor i Përgjithshëm në SHKK me Nr.0171-2021 i datës 18.05.2021; Vendim për shtyrje të afatit në procedurë administrative me Nr.0185-2021 i datës 21.05.2021; Vendim me Nr.742 i datës 28.05.2019; Kërkesë me Nr. 01-138 e datës 26.04.2021; Raporti i auditimit me kërkesë të veçantë të datës 21.04.2021; Kontratë për dhënie në shfrytëzim të parcelës Kadastrale në pronësi të Ministrisë së Drejtësisë-Shërbimit Korrektues të Kosovës me Nr.0964 i datës 06.11.2020; Certifikatë e Regjistrimit nga ARBK me numër e datës 17.08.2020; Numri unik identifikues 811446740; Letër njoftim i J.O.; Regjistri i ofertave të dorëzuar; Certifikatë numri i lëndës 18-1316/20 i datës 19.05.2020- 2 faqe; 3 Fotografi ; Marrëveshje Bashkëpunimi me Nr.179 i datës 05.02.2019; Marrëveshje me Nr. 067 i datës 16.01.2019; Aktgjykimin A.nr.2195/2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 22.09.2022; Aktvendimin A.nr.2550/2018 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 29.10.2018.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për rivendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ka bazë të mjaftueshme ligjore si dhe ekzistojnë rrethana të cilat e plotësojnë kushtin që vendimmarrja për lëndën A.nr.636/2021 të ankuesit të **pezullohet, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, nga administrimi i shkresave të lëndës respektivisht Vendimit Nr.04/2022 të Qeverisë së Republikës së Kosovës ka konstatuar se ankuesi Nehat Krasniqi të datës 27.04.2018 është emëruar Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë me mandat 5 (pesë) vjeçar, ndërsa sipas vendimit të datës 18.06.2021 me numër:0366 Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë i ka shqiptuar ankuesit masën disiplinore "Largim nga Shërbimi Civil" me arsyetimin se i njëjti ka kryer shkelje të rënda të detyrave të punës të përcaktuara me nenin 46 paragrafi 3 në paragrafi 3.3 dhe 3.10 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: "Shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore. Shkelje të rënda konsiderohen: 3.3 moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 3.10 shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi".

Po ashtu, Kolegji i Këshillit nga administrimi shkresave të lëndës ka konstatuar se me qenë se lënda është në procedurë të shqyrtimit në instancë të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative pasi që palët në procedurë në pajtim me dispozitat e LKA kanë hapur konflikt administrativ, për shkak që Këshilli i pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 10.10.2018 ka nxjerrë Vendimin me shifër A.nr.520/2018 me numër protokoll:5883/2018 përmes të cilit e ka aprovuar si të bazuar ankesën e ankuesit A.G, ndërsa në pikën III të dispozitivit të këtij vendimi kishte anuluar konkursin e datës 27.12.2017 të shpallur nga Ministria e Administratës Publike dhe rekomandimin e Komisionit për vlerësim të kriterëve për përzgjedhjen e kandidatit N.Th në pozitën Drejtor i Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës i cili ishte emëruar sipas Vendimit Nr.04/44 të datës 27.04.2018 nga Qeveria e Republikës së Kosovës ,si dhe të gjitha veprimet që rrjedhin prej kësaj procedure të përzgjedhjes.

Mirëpo, ndërlidhur me këtë rast të përcaktuar si më lartë, në cilësi të palës në procedurë e cila asaj kohe sipas dispozitave të ligjit material ishte përgjegjëse të zhvillonte procedurat e rekrutimit për pozitën të larta drejtuese, Ministria e Administratës Publike me datë 25.10.2018 ka parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative kundër Vendimit të Këshillit me shifër A.nr.520/2018 dhe po ashtu e njëjta kishte kërkuar aprovimin masë e sigurisë për pezullimin e ekzekutimit të Vendimit të Këshillit, masë kjo e cila ishte aprovuar sipas Aktvendimit A.nr.2550/2018 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 29.10.2018, ndërsa ishte shtyrë ekzekutimi i vendimit të Këshillit deri në marrjen e aktgjykimit lidhur me kërkesëpadinë e palës paditëse Ministrisë së Administratës Publike, mirëpo lënda si e tillë deri në këtë kohë nuk është shqyrtuar dhe vendosur meritorisht nga ana e Gjykatës respektive, përderisa Këshilli është ftuar sipas thirrjes së rregullit për shqyrtim kryesor në cilësinë e palës së paditur të marr pjesë në seancën e datës 04.11.2021 në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ndërlidhur me konfliktin administrativ për Vendimin A.nr.520/2018.

Andaj, meqenëse Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ende nuk ka vendosur meritorisht lidhur me shqyrtimit e ligjshmërisë së Vendimit të Këshillit A.nr.520/2018 respektivisht konstatimit nëse procedura në të cilën ishte zgjedhur ankuesi kandidat i suksesshëm dhe njëherit ishte emëruar sipas Vendimit të datës 27.04.2018 të Qeverisë së Republikës së Kosovës ka qenë apo jo e ligjshme, Kolegji i Këshillit konstaton se në kuptim të nenit 85 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: "Kur organi publik që zhvillon procedurën has në një çështje, zgjidhja e së cilës është

parakusht për zgjidhjen e çështjes kryesore dhe e cila përbën një çështje juridike të pavarur (në vijim: "çështje paraprake"), për zgjidhjen e së cilës është kompetente një gjykatë apo organ tjetër, organi publik që zhvillon procedurën do të pezullojë çështjen kryesore, deri sa çështja paraprake të jetë vendosur dhe do të njoftojë palën për vendimin e pezullimit", ekzistojnë rrethana të mjaftueshme që rishqyrtimi dhe vendosje për lëndën A.nr.636/2021 të pezullohet deri në vendosjen përfundimtare nga Instancat Gjyqësore Kompetente, pasi që objekti i shqyrtimit shërben si parakusht për zgjedhjen e çështjes kryesore në këtë lëndë, respektivisht ankuesi pretendon se sipas vendimit të datës 18.06.2021 me numër:0366, Këshilli Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë ia ka ndërprerë kundërligjshëm marrëdhënien e tij të punës të fituar sipas Vendimit të datës 27.04.2018 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ndërsa Këshilli me Vendimin A.nr.520/2018 kishte konstatuar se procedura e rekrutimit nga e cila kishte dal si kandidatë i suksesshëm ankuesi dhe njëherit ishte emëruar, është zhvilluar në kundërshtim me dispozitat ligjit material, respektivisht në kundërshtim me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe Ligjit Nr.04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.9 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrtës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenit 85 Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.636/2021, datë 03.11.2022.

Sabile Avdyli



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Vendimi i dërgohet:**

- Përfaqësuesit të Autorizuar shoqërisë së avokatëve,
- Ministrin të Ministrisë së Punëve të Brendshme
- Sekretarin të Përgjithshëm në Qeverinë e Republikës së Kosovës;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Qeverinë e Republikës të Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

